

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Edukatë qytetare

(klasa e tetë)

Tiranë, tetor 2005

1. Të përgjithshme

Përmbajtja e edukimit qytetar

Edukimi për qytetari demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ai lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si i tillë ai përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- **Përmasën politike**, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik;
- **Përmasën ligjore**, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve;
- **Përmasën kulturore**, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe, njëkohësisht, të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore;
- **Përmasën shoqërore dhe ekonomike**, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike;
- **Përmasa evropiane**, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian;
- **Përmasën globale**, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global.

2. Synimet

Programi i lëndës së edukatës qytetare për klasën e tetë të arsimit nëntëvjeçar bazohet pothuajse në të gjitha linjat e standardeve të lëndës së edukatës shoqërore të miratuara nga MASH në vitin 2002, në prerjen dhe ndërlidhjen e tyre, të para nën këndvështrimin e edukimit global

a. Synime të përgjithshme të lëndës

Gjatë zhvillimit të kësaj lënde, nxënësit t'i jepet mundësia

- të zbulojë dhe të kuptojë të jetuarit në një botë të ndërvarur se ai dhe të tjerët janë në marrëdhënie të kushtëzimit reciprok për të gjitha fushat e jetës.
- ta ndiejë veten si pjesë e një grupi, bashkësie, kombi, rajoni e bote, në marrëdhënie të ngushtë me mjedisin.
- të shqyrtojë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet bashkësive e vendeve dhe të dallojë dhe të kuptojë ndikimin që kanë (efekti domino) ngjarjet ose veprimet që ndodhin në rajone të ndryshme të vendit ose të botës me njëra-tjetrën.
- të zhvillohet për t'u bërë një qytetar i mirinformuar, i përgjegjshëm dhe pjesëmarrës i bashkësisë, vendit, rajonit dhe botës të cilës i përket.

- të zbulojë, të shqyrtojë dhe të diskutojë pasojat pozitive ose negative të veprimeve të tij dhe të tjerëve, të veprimeve të qeverisë dhe të organizatave ndërkombëtare.
- të shfaqë në veprime konkrete vetëdijen dhe përgjegjësinë e tij prej qytetari global për mjedisin ku jeton.

b. Synime të veçanta të lëndës

Lënda e edukatës qytetare e klasës së tetë duhet t'i shërbejë *zhvillimit të njohurive, të aftësive intelektuale dhe të prirjeve qytetare të nxënësve*. Nëpërmjet tij programi **synohet:**

- Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë se pikëpamja e tyre për botën formohet dhe kufizohet nga përvoja e tyre vetjake, si dhe nga kultura, klasa, kombësia, raca, gjinia, brezi ku bën pjesë etj. (*Këndvështrime të kufizuara*)
- Të ndihmohen nxënësit të mësojnë rreth mënyrës së tyre të jetesës nëpërmjet studimit të faktit si të tjerët e shohin atë. (*Si na shohin të tjerët*)
- Të ndihmohen nxënësit të mësojnë faktet kryesore e kuptimplote/të rëndësishme gjeografike, politike, shoqërore dhe ekonomike të botës. (*Faktet*)
- Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë çështjet, prirjet dhe zhvillimet globale. (*Çështjet*)
- Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë natyrën e ndërvarur dhe sitemike të botës. (*Ndërvarësia*)
- Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë dhe të ndjejnë mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve, veçanërisht të atyre që u përkasin kulturave, klasave, kombësive, racave, gjinive dhe brezave të ndryshëm. (*Empatia*)
- Të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë shprehitë e analizës kritike për të qenë të aftë të zbulojnë njëanshmëritë dhe për të formuar gjykimin e tyre për atë çfarë mësojnë nga media informative etj. dhe për atë që dëgjojnë në klasë. (*Shprehitë kritike*)
- Të ndihmohen nxënësit të bëhen të vetëdijshëm për anët e tyre të forta dhe të dobëta, njëanshmëritë dhe paragjykimet dhe të ndihmohen ata të arrijnë të vlerësojnë dhe të respektojnë veten. (*Njohja e vetvetes*)
- Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë të përbashkëtat në nevoja, në talente dhe dëshira në të gjithë botën. (*E përbashkëta*)
- Të ndihmohen nxënësit të imagjinojnë, të përfytyrojnë dhe të respektojnë për të ardhmet e mundshme në nivel vetjak, lokal, kombëtar dhe global dhe të

- ndihmohen ata të zhvillojnë shprehitë e nevojshme për të arritur të ardhmet e dëshiruara. (*E ardhmja*)
- Të ndihmohen nxënësit të mësojnë si të përballen dhe të arrijnë të kontrollojnë fatin e tyre në një botë gjithnjë e në ndryshim. (*Shmangia e shokut psikologjik*)
 - Të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë dhe të praktikojnë shprehitë e nevojshme për pjesëmarrje aktive dhe demokratike në bashkësinë e shkollës, të lagjes, vendit dhe të bashkësisë botëror. (*Pjesëmarrja*)
 - Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë konceptin e ndryshimit, si dhe mjetet dhe rrugët për të ndikuar në të. (*Ndryshimi i botës*)
 - Të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë shprehitë e komunikimit efektiv, përfshirë shprehitë e të dëgjuarit, shprehitë e të shprehurit gojor dhe me forma të tjera. (*Komunikimi*)
 - Të ndihmohen nxënësit të vlerësojnë pasurinë kulturore që ofrojnë kulturat brenda dhe jashtë grupimeve shoqërore ku bëjnë pjesë. (*Pasuria kulturore*)
 - Të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë respektin e tyre për të drejtat, ndjenjat dhe vlerën dhe dinjitetin e qenieve njerëzore dhe qenieve të gjalla. (*Respekti*)
 - Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë dhe të provojnë në praktikë rëndësinë e bashkëpunimit dhe të zhvillojnë shprehitë e duhura, si: shprehitë për shmangien dhe zgjidhjen e konflikteve. (*Bashkëpunimi*)
 - Të ndihmohen nxënësit të vlerësojnë se marrëdhëniet ndërmjet individëve, grupeve dhe shoqërisë duhet të ngrihen mbi bazën e barazisë. (*Barazia*)
 - Të ndihmohen nxënësit të kuptojnë se parimi i drejtësisë nënkupton pjesëmarrjen e drejtpër drejtë për të mbrojturr të drejtat e të tjerëve. (*Drejtësia*)
 - T'u paraqiten nxënësve alternativa dhe vizione të ndryshme të realitetit, si dhe strategji për të arritur ndryshime vetjake dhe shoqërore. (*Vizionet alternative*)
 - Të ndihmohen nxënësit të zhvillojnë shprehitë e duhura studimore, si: planifikimi, organizimi dhe ndjekja e hulumtimeve të pavarura, nxjerrja dhe vlerësimi i përfundimeve. (*Shprehitë e studimit*)

Shënim.

Synimet e përgjithshme dhe ato të veçanta, të radhitura më sipër, si dhe konceptet kryesore të lëndës (në kllapa) do të realizohen, në shkallën më të madhe që mundëson mosha e nxënësve në klasën e tetë, përmes objektivave të mësipërm.

Për të shmangur përsëritjen e aftësive intelektuale dhe të aftësive pjesëmarrëse që synohen të realizohen përmes këtij programi, në vijim është përcaktuar korniza në të cilin ato do të realizohen. Kjo mundëson dhe kërkon përdorimin e aftësive krijuese të përdoruesve të këtij programi si të autorëve të tekstit, ashtu edhe të mësuesve në shfrytëzimin sa më të mirë të kësaj kornize.

3. Linjat kryesore

Në këtë program trajtohen çështje që kanë të bëjnë me të gjitha linjat e mëposhtme. Kënvështrimi që i lidh ato me njëra tjetrën është këndvështimi global, domethënë këndvështrimi që ka në themel trajtimin e botës si një sistem në të cilin të gjitha dukuritë, ngjarjet, veprimet njerëzore janë të ndërvarura me njëra tjetrën dhe kushtëzojnë njëra tjetrën.

1. Kultura,
2. Koha, vazhdimësia, ndryshimi,
3. Njerëz, vende, mjedise,
4. Zhvillimi vetjak dhe identiteti,
5. Individët, grupet dhe institucionet,
6. Pushteti, autoriteti, qeverisja,
7. Prodhimi, shpërndarja, konsumi,
8. Shkenca, teknologjia, shoqëria,
9. Lidhjet globale,
10. Idealet dhe praktikët e shoqërisë.

4. Tematikat kryesore, objektivat përkatës dhe shpërndarja e orëve

Kurrikula zyrtare/përsëritje	30 orë
Kurrikula në dispozicion të mësuesit	5 orë
Totali	35 orë

Linjat e standardeve	Kreu/Objektivat	Konceptet	Numri i orëve
----------------------	-----------------	-----------	---------------

<p>Kultura,</p> <p>Njerëz, vende, mjedise,</p> <p>Zhvillimi vetjak dhe identiteti,</p> <p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Prodhimi, shpërndarja, konsumi,</p>	<p>KREU I. NDËRVARËSIA E INDIVIDIT ME TË TJERËT</p> <p>Në këtë kre, nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë dhe të shpjegojë ndërvarësinë e jetës njerëzore në nivel <ul style="list-style-type: none"> ○ Vetjak, ○ Familjar, ○ Komunitar, ○ Kombëtar, ○ Rajonal, ○ Botëror. • Të përshkruajë marrëdhëniet e tij (çfarë merr dhe çfarë jep): <ul style="list-style-type: none"> ○ Me individët e tjerë, ○ Me grupin shoqëror ku bën pjesë, ○ Me familjen, ○ Me lagjen, ○ Kombin, ○ Me rajonin etj. • Të përshkruajë si kanë ndryshuar këto marrëdhënie gjatë jetës së tij. 	<p>Ndërvarësi</p> <p>Ndryshim</p> <p>Marrëdhënie</p> <p>Trashëgimi</p> <p>Komunitet</p> <p>Rajon</p> <p>Botëror</p>	<p>7 orë</p>
<p>Kultura,</p> <p>Koha, vazhdimësia, ndryshimi,</p> <p>Njerëz, vende, mjedise,</p> <p>Zhvillimi vetjak dhe identiteti,</p> <p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Shkenca, teknologjia, shoqëria,</p>	<p>KREU II NDËRVARËSIA E INDIVIDIT ME MJEDISIN KULTUROR KOMBËTAR DHE RAJONAL</p> <p>Në këtë kre nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë disa nga tiparet e identitetit kombëtar: <ul style="list-style-type: none"> ○ Të identifikojë dhe të përshkruajë veçoritë e tij në kuadrin e mjedisit kulturor në të cilin bën pjesë (ku dallon nga shokët e klasës ose të mjedisit ku jeton); ○ Të identifikojë dhe të përshkruajë të përbashkëtat me nënkulturat e tjera (cilat janë të përbashkëtat që ai ka me shokët e klasës ose të lagjes ku jeton). • Të dallojë tiparet e identitetit evropian (eksplorimi i Evropës): 	<p>Kulturë</p> <p>Nënkulturë</p> <p>Identitet kulturor</p> <p>Identitet kombëtar</p> <p>Identitet evropian</p> <p>Zhvillim kulturor</p> <p>Veçori kulturore</p> <p>Tipare të përbashkëta</p>	<p>7 orë</p>

Lidhjet globale,	<ul style="list-style-type: none"> ○ Të identifikojë disa nga veçoritë që mendon se i takojnë qytetarit evropian; ○ Të eksplorojë disa nga fushat kryesore të jetës në Evropë, si: kultura, muzika, veshja, mjedisi etj.; ○ Të përshkruajë disa nga tiparet e njohura të fqinjëve tanë. ● Të dallojë dhe të përshkruajë tipare, ide, qendrimet që janë të veçanta për kulturën tonë krahasuar me ato të kulturave të tjera: <ul style="list-style-type: none"> ○ Të përshkruajë veten e tij si qytetar i Shqipërisë; ○ Të përshkruajë veten e tij si qytetar i Evropës. ● Të përshkruajë anët pozitive dhe negative të të qenit vetëm shqiptar. 		
<p>Kultura,</p> <p>Njerëz, vende, mjedise,</p> <p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Prodhimi, shpërndarja, konsumi,</p> <p>Shkenca, teknologjia, shoqëria,</p> <p>Lidhjet globale,</p>	<p style="text-align: center;">KREU III. LIDHJA DHE NDËRVARËSIA E SHQIPËRISË ME FQINJËT, EVROPËN DHE BOTËN</p> <p>Në këtë kre nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Të dallojë dhe të përshkruajë disa nga pikat e kontaktit të vendit tonë me Evropën: <ul style="list-style-type: none"> ○ Në fushën kulturore, ○ Në fushën ekonomike, ○ Në fushën shoqërore, ○ Në fushën arsimore, ○ Në fushën shtetërore, ○ Në fushën ligjore. ● Të përmendë organizmat ndërkombëtare në nivel evropian dhe botëror, si: OKB, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, strukturat dhe qëllimet themelore të veprimtarisë së tyre. ● Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit të Shqipërisë me secilin prej këtyre organizmave, parë ky bashkëpunim në planin ekonomik, kulturor, social, politik etj. ● Të shpjegojë rolin e organizmave në 	<p>Zhvillim</p> <p>Ndërvarësi</p> <p>Pasoja ekonomike</p> <p>Pasoja shoqërore</p> <p>Përfitim i ndërsjellë</p> <p>Bashkëpunim</p> <p>Organizma ndërkombëtare</p>	<p>7 orë</p>

	<p>ngjarje të caktuara dhe mënyrat si ato ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në botë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë shembuj nga jeta e përditshme ose nga media të formave të bashkëpunimit të Shqipërisë me Këshillin e Evropës, OKB-në dhe Bashkimin Evropian. • Të vlerësojë si ndikon në jetën e individit bashkëpunimi me këto organizma. • Të vlerësojë si ndikon në jetën komunitetit dhe të kombit bashkëpunimi me këto organizma. • Të tregojë rrugët e bashkëpunimit ndërkombëtar në të mirë të parandalimit të problemeve të ndryshme globale. • Të demonstrojë vlera të respektimit dhe solidaritetit me vendimet e marra nga organizmat ndërkombëtare në mirë të paqes botërore. 		
<p>Individët, grupet dhe institucionet,</p> <p>Pushteti, autoriteti, qeverisja,</p> <p>Prodhimi, shpërndarja, konsumi,</p> <p>Shkenca, teknologjia, shoqëria,</p> <p>Idealet dhe praktikat e shoqërisë.</p>	<p>KREU IV. DISA NGA PROBLEMET GLOBALE DHE VEPRIMI POLITIK DHE QYTETAR NË KUADRIN E NDËRVARËSISË GLOBALE</p> <p>Në këtë kre nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të evidentojë format e shfaqjes së problemeve globale, si: ndotja e mjedisit, ruajtja e burimeve natyrore etj. në vendin tonë. • Të analizojë shkaqet dhe pasojat që sjellin problemet e mjedisit në bashkësinë e tij, në Shqipëri dhe më gjerë. • Të vlerësojë në mënyrë kritike qëndrimet e politikës vendëse ndaj problemeve globale. <ul style="list-style-type: none"> ○ Të identifikojë disa nga problemet globale që ndeshen në lagjen, bashkësinë ose në vendin e tij 	<p>Problem global</p> <p>Mjedis,</p> <p>Ndotje mjedisore,</p> <p>Burime natyrore,</p> <p>Energji</p> <p>Ruajtje burimeve natyrore, Vazhdimësi</p> <p>Zhurma,</p> <p>Droga,</p>	<p>9 orë</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Të identifikojë disa nga politikat e ndërmarra për të zgjidhur problemin nga: <ul style="list-style-type: none"> – Pushteti lokal, – Shteti, – Organizata joqeveritare. • Të ndërmarrë veprime konkrete që kanë pasoja jo vetëm për mjedisin ku jeton, por edhe më gjerë <p>Të demonstrojë aftësi praktike për të ndërmarrë veprime konkrete në të mirë të përmirësimit të situatës mjedisore në komunitet.</p>	<p>Sida,</p> <p>Trafikim</p> <p>Trafikim qeniesh njerëzore,</p> <p>Trafikim organesh</p> <p>Prostitucion</p> <p>Alkoli,</p> <p>Makinat,</p>	
--	--	---	--

5. Metodologjia e zbatimit të programit

A. Disa parime metodologjike për zhvillimin e lëndës së edukimit qytetar në shkollë

Edukimi për qytetari demokratike është një proces që zgjat gjithë jetën. Si i tillë ai është proces i të nxënësve social, domethënë është të nxënë për, në dhe rreth shoqërisë, në të njëjtën kohë është të nxënësve për të jetuar së bashku. Ai nënkupton demokratizimin e të nxënësve, duke u përqendruar te nxënësi dhe në pavarësinë e përgjegjësinë e tij në procesin e të nxënësve, duke nënkuptuar me këtë edhe bashkërendimin e procesit të të nxënësve dhe të mësimdhënies.

Edukimi për qytetari demokratike arrihet nëpërmjet metodave të shumëllojshme e të ndërlidhura të të nxënësve, në të cilin ndërthuren lloje të tilla të edukimit, si, për shembull, edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias etj.

Edukimi për qytetari demokratike bazohet në përvojën dhe praktikën vetjake. Si i tillë ai kërkon një kurrikul të hapur që të përfshijë metoda pjesëmarrëse dhe ndërvepruese, të cilat bazohen në të nxënësve nëpërmjet përvojës, veprimit dhe bashkëveprimit.

Pra, **edukimi për qytetarinë demokratike synon të zëvendësojë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve**, në të cilat roli i mësuesit nënkuptohet vetëm në transmetimin e dijeve dhe të aftësive dhe roli i nxënësit në të dëgjuarit pasiv dhe, në rastin më të mirë, në përvetësimin e përmbajtjes së transmetuar. Edukimi për qytetarinë demokratike nënkupton mundësitë e shumta të të mësuarit që mundëson “shoqëria e të nxënësve”. Ai del përtej kufijve të shkollës dhe të bashkësisë dhe sfidon ndarjen ndërmjet edukimit formal dhe joformal, ndërmjet **veprimtarive kurrikulare, kroskurrikulare dhe jashtëshkollore**, si dhe ndërmjet shkollimit dhe shoqërizimit. Si i tillë, ai zhvillon karakterin e ndërsjellë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe nxit këmbimin e vazhdueshëm të rolit të mësuesve dhe të nxënësve. Në të njëjtën kohë, duke u përqendruar në fitimin e aftësive dhe të kompetencave të nevojshme për veprimin dhe ndryshimin shoqëror, edukimi për qytetarinë demokratike ruan të gjitha karakteristikat e një përpjekjeje të paramenduar njerëzore që harmonizon teorizimet dhe diskutimin publik.

Në këtë kuadër, mësuesit shfaqen më tepër si **organizatorë të mundësive të shumëfishta të të mësuarit** dhe si ura që lidhin burimet shoqërore me përdoruesit e tyre. Ata ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë mundësinë e marrjes së informacionit dhe ndjekin në vazhdimësi sfidat e reja shoqërore, politike dhe teknologjike, si dhe nevojat gjithnjë në rritje të nxënësve të tyre. Nxënësit, gjithashtu, marrin pjesë aktivisht në vendimet lidhur me procesin edukativ, veçanërisht në ato që lidhen me përmbajtjen, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies/të nxënësve për qytetarinë demokratike. Mësimdhënia duhet të bëhet një proces ndërveprues, në të cilin jo vetëm diskutohen qëllimet arsimore, por edhe njihen e shikohen kolektivisht përvojat e fituara.

B. Cilat janë aftësitë që duhet të ketë mësuesi si zbatues i programit të klasës së tetë

Zbatimi i këtij programi kërkon një mësues që të jetë në koherencë të plotë me objektivat e sipërpërmendur si në drejtim të njohurive, ashtu edhe të aftësive të nevojshme për një mësimdhënie cilësore. Pra, çfarë kërkohet konkretisht nga mësuesi i lëndës së edukimit qytetar të klasës së tetë?

Nga mësuesi kërkohet:

- **Të ndiejë** veten si qytetar të botës, të kuptuar në ndërvlerësinë dhe kushtëzimin e saj dhe të ndihmojë nxënësit të hulumtojnë në gjendjen e sotme globale, duke nxitur mbajtjen e qëndrimit të tij për çështjet aktuale globale dhe argumentet rreth tyre.
- **Të interesohet** rreth kulturës së të ardhmes dhe të përpiqet të zhvillojë te nxënësit shkallën e të kuptuarit të kulturës përtej bashkësisë ku bën pjesë; t'i nxisë nxënësit të vlerësojnë dhe të pranojnë diversitetin dhe të bëhen të ndjeshën dhe të hapur ndaj pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tjera për botën.
- **Të orientohet** gjithmonë nga e ardhmja, ta ndihmojë nxënësit të mbajnë qëndrim për të ardhmen e tyre dhe të edukojë te ta shprehinë dhe aftësitë e duhura për pjesëmarrje në proceset politike e sociale të shoqërisë.

- **Të lehtësojë** procesin e të nxënit dhe të përpiqet të fitojë aftësitë e nevojshme për rolin e tij si lehtësues.
- **Të ketë besim** në mundësitë e nxënësve, të besojë se edhe ata janë qenie njerëzore me ide dhe përvoja që mund t'i ndajnë me të tjerët, pra dhe me të. Ai t'ua krijojë nxënësve këtë mundësi.
- **Të përdorë** larmi të madhe teknikash e stilesh mësimore dhe të bëjë kujdes që nxënësit të ndihem mirë dhe të sigurtë në klasë.
- **Të vlerësojë** të nxënit si një proces që zgjat gjatë gjithë jetës dhe t'i nxisë nxënësit të bëjnë kujdes që të mos përpiqen të ofrojnë gjithnjë përgjigje përfundimtare.
- **Të respektojë** të drejtat e njeriut dhe të punojë që nxënësit në mënyrë të pavarur të ushtrojnë aftësitë e tyre të gjithanshme në një mjedis demokratik dhe pjesëmarrës.
- **Të kërkojë** gjithmonë lidhjen ndërlëndore, funksionale në kurrikulin shkollor dhe të përpiqet të harmonizojë synimet, objektivat dhe strategjitë e të mësuarit dhe të vlerësimit gjatë gjithë zbatimit të kurrikulit.

C. Zbatimi i kurrikulës së lirë

Qëllimi i kurrikulës së lirë (15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive arsimore që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimimit

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t'i shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të prgjithshme të lëndës së edukimit qytetar e formave të tjera të edukimit që lidhen me të.

Grumbullimi i fakteve, i shifrave dhe i të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi, të shoqëruara me vrojtme dhe me detyra në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit; organizimi i konkurseve dhe i lojërave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesëmarrëse dhe fuqizojnë të nxënësit dhe zhdërvjelltësojnë procesin e mësimdhënien, sugjerohen për t'u zhvilluar nga mësuesi në kuadrin e orëve që ai ka në dispozicion.

Për rritjen e efektshmërisë së kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që mundësojnë edhe realizimin e lidhjeve ndërlëndore.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duhet të bëhet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashtrojnë veçoritë vendore.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

D. Lidhja ndërlëndore

Edukimi qytetar duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e edukimi qytetar dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

1. Së pari, edukimi qytetar mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
2. Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e edukimit qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Historia dhe Edukimi qytetar

Lënda e historisë dhe ajo e edukimit qytetar kanë të përbashkët:

1. **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
2. **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj

Edukimi qytetar:

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ai i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe edukimit qytetar?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuar në lëndën e historisë në kurrikulën e edukimit qytetar me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimit;
- Të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar;

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të edukimit qytetar. Kështu, lidhja ndrmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

II. Gjeografia dhe edukimi qytetar

1. Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia dhe Edukimi qytetar? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj,
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj,

2. Si mund tëndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së edukimit qytetar:

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë;
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale;
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë;
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm;
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. Në ç'mënyrë lënda e edukimit qytetar ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë? Edukimi qytetar:

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- Nxiti të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme;
- Nxiti nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së gjeografisë dhe edukimit qytetar?

1. Së pari, mësimet e gjeografisë duhet të kenë si pjesë përbërëse përmasën e qytetarisë ose “prirjen qytetare”. Ato duhet të lidhen me konceptet e qytetarisë, si për shembull, me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, si dhe të përfshijnë veprimtari të tilla si diskutimet etj.
2. Së dyti, përmasa e qytetarisë duhet gjatë zhvillimit të temave të edukimit qytetar duhet:
 - Të jetë çështja thelbësore e mësimet;
 - Të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar;

III. Shkenca dhe edukimi qytetar

Shoqëria e sotme, vazhdimisht shtron përpara nesh çështje që lidhen me jetën tonë si në plan vetjak ashtu edhe në plan shoqëror. Trajtimi dhe zgjidhja e këtyre çështjeve, shpesh herë, kërkon jo vetëm njohuri shkencore, por edhe aftësitë dhe shprehjet për t’u përfshirë në diskutime morale dhe veçanërisht për të bërë gjykime kritike.

Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet shkencës dhe qytetarisë?

- Dilemat etike që shoqërojnë vendimet dhe kërkimet shkencore, për shembull, a mund të përdoren kafshët për të bërë kërkime shkencore?
- Çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull, çështja e ngrohjes globale;
- Ndikim i përparimeve teknike në shoqëri, për shembull, ndikim i internetit;
- Kontrolli i shkencës, për shembull, shpërndarja e fondeve për kërkime shkencore (do të përdorim miliarda lekë për të provuar që ka jetë në Mars, apo do t’i përdorim këto lekë për qëllime të tjera më të rëndësishme për shoqërinë e sotme?)

Lënda e edukimit qytetar duhet të ndihmojë nxënësit:

- të reflektojnë dhe të diskutojnë për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore;
- të vlerësojnë rolin qendror të shkencës në botën e sotme;
- të kuptojnë karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.

Autorët e teksteve dhe mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së edukimit qytetar, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje, jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve të edukimit qytetar, por, duke ritheksuar

lidhjen e edukimit qytetar me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin e tyre për këtë lëndë.

Mësuesit duhet të zgjedhin me kujdes pjesën nga kurrikula e shkencave të natyrës dhe të përcaktojnë jo vetëm objektivat e të nxënësve por edhe mënyrën për t'i zbatuar ato qartësisht tek nxënësit. Këta të fundit duhet të kenë të qartë se po trajtojnë një çështje të edukimit qytetar

6. Vlerësimi në lëndën e edukimit qytetar

Standardet e përmbajtjes së lëndës së edukimit qytetar përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një të rëndësishëm në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse*. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare* që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme,
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të të tjerëve. *Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.